



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 273, datë 23.12.2024

PËR

**“CAKTIM TË PËRKOSSHËM TË DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM KUKËS”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
3. Zotit Zeqir HODA	Anëtar
4. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
5. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
6. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
7. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
8. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar (në mungesë)
9. Zotit Erind GËRMENJI	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zoti Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 23.12.2024, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe Relacionin shpjegues të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës shqyrtoi çështjen me objekt:

“Caktim të përkohshëm të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”

BAZA LIGJORE:



1. Neni 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
2. Neni 59 pika 1 dhe 4, të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
3. Nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa "a" të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar;
4. Rregullore "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve" e ndryshuar.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- i. Relacioni shpjegues i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës nr.2735 prot., datë 20.12.2024;
- ii. Projektvendimi i formatuar;

si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Brenda kompetencave ligjore dhe nënligjore, ai shqyrton, miraton ose refuzon kërkesat e prokurorëve për veprimtari jashtë funksioni.
2. Si rezultat i shkarkimit nga detyra dhe pezullimit të drejtuesve të mëparshëm, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, pozicioni i drejtuesit të kësaj prokurorie ka ngelur vakant.
3. Me qëllim plotësimin e vakancës së krijuar për shkakun e sipërcituar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka shpallur thirrjen për plotësimin e vakancës nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë me vendimin nr. 293, datë 31.07.2023.
4. Në përfundim të afatit të caktuar, nuk ka pasur asnjë kandidat që ka shprehur interesin për të kandiduar në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Me vendimin nr. 12, datë 16.02.2024, Këshilli ka shpallur sërish thirrjen për plotësimin e këtij pozicioni, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Në përfundim të afatit për aplikim, nuk ka pasur asnjë kandidat që ka shfaqur interesin për pozicionin e drejtuesit në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe me vendimin nr. 38, datë 28.03.2024, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, procedura është mbyllur për mungesë kandidature.
5. Në këto kushte, Komisioni vendosi të vijojë procedurën për plotësimin e kësaj vakance nëpërmjet caktimit të përkohshëm të një prokurori. Kjo procedurë, bazohet parashikimet e nenit 42 të ligjit për statusin, i cili në pikën 1, parashikon se:

"Pozicioni i magistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të:



- a. caktimit në pozicione të tjera;
- b. arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji;”

Ndërsa, neni 42 pika 2, i ligjit të sipërpërmendur përcakton se:

“ 2... Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.”

Ndërkohë, neni 3 i Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, përcakton se:

“1.Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër.

2.Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm.”

6. Në aplikim të sa më sipër, Këshilli me vendimet nr. 396, datë 14.12.2023, nr. 23, datë 07.03.2024, nr.79 datë 18.06.2024, ka vendosur të caktojë përkohësisht zonjën Enkeleda Hoxha, të ushtrorë detyrën e drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe së fundmi me vendimin nr.193 datë 17.09.2024, për periudhën 20.09.2024 – 19.12.2024.
7. Këshilli më datë 25.11.2024, ka publikuar thirrjen për aplikim lidhur me procedurën e ngritjes në detyrë për drejtues prokurorie pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës. Në përfundim të afatit të përcaktuar nuk ka pasur aplikime nga ana e prokurorëve për këtë pozicion.

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konstaton se:

8. Pozicioni i drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës mbetet sërish vakant, si dhe duke vlerësuar se vazhdon të jetë e njëjta situatë edhe në këtë fazë të procedurës për caktimin e përkohshëm të drejtuesit të prokurorisë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, bazuar në dispozitat ligjore, rregulloren për caktimin e përkohshëm të prokurorëve, konstatoi se, zonja Hoxha plotëson kriteret ligjore për t’u caktuar përkohësisht në pozicionin e drejtuesit të kësaj prokurorie, për një afat tjetër deri në tre muaj. Gjatë kësaj periudhe, prokurorja Enkeleda Hoxha do të përfitojë pagën e drejtuesit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës, nenin 59, pika 1 dhe 4 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,



VENDOSI:

1. Zonja Enkeleda Hoxha, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Kukës.
2. Zonja Enkeleda Hoxha, do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, nga data 23.12.2024 – 22.03.2025.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zonja Enkeleda Hoxha do të paguhet me pagën e pozicionit të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.
4. Të njoftohen për këtë vendim zonja Enkeleda Hoxha, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare ëeb të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 23.12.2024.



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erion Fejzulla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Erind Gërmenji